



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**KËSHILLI DREJTUES**

**Nr. Prot. 895/2**

**Tiranë 29.12.2022**

**VENDIM QARKULLUES**

**Nr. 38, datë 29.12.2022**

**PËR**  
**MIRATIMIN E FORMATIT STANDARD TË SKEDARËVE**  
**TË RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE NGA**  
**BANKAT DHE SHOQËRITË E KURSIM - KREDITIT**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 3, pika 3, të nenit 26, të nenit 51, pika 4 dhe të nenit 52, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 22, pika 1 të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014 “Për sigurimin e depozitave në banka”, i ndryshuar, të nenit 25, pika 1 të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016 “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim - kreditit”, i ndryshuar, të nenit 7, pika 6 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 dhe të nenit 18 të rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë formatin standard të skedarëve të të dhënave që bankat raportojnë në sistemin informatik për raportim dhe kompensim të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë formatin standard të skedarëve të të dhënave që shoqëritë e kursim - kreditit raportojnë në sistemin informatik për raportim dhe kompensim të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohen bankat dhe shoqëritë e kursim – kreditit, anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, për zbatimin e këtij vendimi. Raportimi i të dhënave nga bankat dhe shoqëritë





e kursim - kreditit, sipas pikës 1 dhe pikës 2 të këtij vendimi, do të fillojë nga data 1 Prill 2023.

4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.
5. Vendimi Qarkullues i Këshillit Drejtues nr. 26, datë 17.10.2016 “Për miratimin e formatit standard të të dhënave për bankat dhe shoqëritë e kursim - kreditit” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

